



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KESHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.2529, datë 23.12.2014

Për

“Miratimin e dokumentit “Rregullore për administrimin e interferencave”, dhe publikimin e mendimeve dhe komenteve të paleve te interesuara mbi këshillimin publik te realizuar për këtë dokument”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. M.Drushku, në mbledhjen e datës 23.12.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e dokumentit “Rregullore për administrimin e interferencave” dhe publikimin e mendimeve dhe komenteve të paleve te interesuara mbi këshillimin publik te realizuar për këtë dokument”.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 9 dhe 10 e nenit 3, gërma a), l) , p), f) n) rr) e nenit 8, neni 110, neni 114, neni 115, neni 134 e në vijim, të Ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, (ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”);
2. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”, i ndryshuar.
3. Ligji nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;

4. Vendimi i Keshillit Drejtues te AKEP Nr.2510, datë 30.10.2014 për "Miratimin e dokumentit për këshillim publik "Rregullore mbi administrimin e interferencave".

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor te grupit te punes si me poshte:

1. Relacioni shpjegues mbi Projektvendimin per miratimin e dokumentit "Rregullore për administrimin e interferencave" ;
2. Projekt akti i paraqitur për miratim: "Rregullore për administrimin e interferencave";
3. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
4. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Dokumenti "Rregullore mbi administrimin e interferencave", është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës duke patur parasysh dhe duke implementuar objektivat rregullator të AKEP.
2. Qëllimi i Rregullores mbi administrimin e interferencave është percaktimi i rregullave per administrimin e interferencave dhe procedurat qe ndiqen per zgjidhjen e tyre ne rastet e ankesave per interferenca te demshme qe shkaktohen nga sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (*sipërmarrësve*) dhe cdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike i pajisur /i pa paisur me Autorizim Individual per perdorimin e frekuencave, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe nënligjore, kompetencat e AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E

Duke marrë në konsideratë:

1. Ligjin Nr. 8485, date 12.05.1999 "Kodi i procedurave administrative".
2. Pika 9 dhe 10 e nenit 3, gërma a), l) , p), f) n) rr) e nenit 8, neni 110, neni 114, neni 115, neni 134 e në vijim, të Ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", (*ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"*);

3. Ligji nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
4. Vendimi i Keshillit Drejtues të AKEP Nr.2510, datë 30.10.2014 për “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Rregullore mbi administrimin e interferencave”.

V E N D O S :

1. Të miratojë përfundimin e këshillimit publik mbi dokumentin “Rregullore për administrimin e interferencave”, dhe të publikojë mendimet dhe komentet e paleve të interesuara sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të miratojë dokumentin “Rregullore për administrimin e interferencave”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI _____

2. Alketa MUKAVELATI _____

3. Benon PALOKA _____

4. Zamira NURÇE _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RR E G U L L O R E

Nr. 35 datë 23.12.2014

PER

“ADMINISTRIMIN E INTERFERENCAVE”

Miratuar me Vendim Nr.2529, datë 23.12.2014 të Këshillit Drejtues

Neni 1

Qëllimi

- 2.1. Qëllimi i Rregullores është përcaktimi i rregullave për administrimin e interferencave dhe procedurat që ndiqen për zgjidhjen e tyre në rastet e ankesave për interferencë të dëmshme që vijnë nga sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (*sipërmarrësve*) dhe çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike i pajisur me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe nënligjore, kompetencat e AKEP.
- 2.2. Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm dhe pa interferencë të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike.

Neni 2

Objekti

Objekti i rregullores është përcaktimi i procedurave për administrimin e interferencave që kryen AKEP në zbatim të detyrimeve dhe ushtrimit të kompetencave ligjore, gjatë monitorimit të spektrit të frekuencave si dhe zgjidhjen e ankesave për interferencat e dëmshme ndaj sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike (*sipërmarrësve*), si dhe çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike (subjekti) sipas ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i pajisur me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave, për të mundësuar krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe pa interferencë të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike.

Neni 3

Baza ligjore

AKEP për hartimin e kësaj rregulloreje mbështetet në:

- 3.1. Ligjin nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (gërma a), l) , p), e nenit 8, neni 110, neni 114, neni 115, neni 132 , neni 133 e në vijim.
- 3.2. Vendimet dhe rekomandimet e Komitetit Europian të Komunikimeve Elektronike (ECC), Komitetit Europian të Radiokomunikacioneve (ERC) dhe Radioregulloret e ITU , Publikimet e CEPT , Direktivat Europiane;

Neni 4 Termet Teknike

Në zbatimin të kësaj rregulloreje, termet që do të përdoren kanë kuptimet e mëposhtme, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, ndërsa çdo term i pacaktuar në vijim do të përcaktohen në përputhje me Ligjin 9918 datë 19.05.2008, i ndryshuar "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë".

- 4.1. "**Caktimi**" është dhënia në përdorim nga AKEP, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9918, e frekuencave që përdoren sipas Planit Kombëtar të Frekuencave në Republikën e Shqipërisë nga një ose më shumë përdorues për shërbime tokësore ose radiokomunikime.
- 4.2. "**Aplikant**" është një person i cili ka aplikuar për Autorizim në përputhje me Ligjin 9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- 4.3. "**Aplikim**" është një kërkesë për Autorizim i cili jepet nga AKEP sipas një procedure të parashikuar.
- 4.4. "**Frekuenca e Caktuar**" është dhënia e autorizimit për përdorimin e një frekuence apo kanali frekuence, sipas kushteve specifike.
- 4.5. "**Brezi i Frekuencës së Caktuar**" është shtrirja nga frekuenca minimale në atë maksimale me secilin emetim të stacionit të caktuar nga AKEP.
- 4.6. "**Autorizim**" është një e drejtë përdorimi e Brezitet të Frekuencës i dhënë nga AKEP.
- 4.7. "**Përdorues i Autorizuar**" është një person të cilit i është dhënë një e drejtë përdorimi e Brezitet të Frekuencës nga AKEP.
- 4.8. "**Tipi i Autorizimit**" është e drejta e përdorimit të Brezitet të Frekuencës e cila lejon operimin e pajisjeve Wireless nga një person në brezat e frekuencës sipas kushteve të përcaktuara nga AKEP.

- 4.9. **“Interferencë”** është ndikimi i një energjie të padëshiruar, të shkaktuar nga një ose më shumë kombinime të emetimeve, rrezatimeve ose induktimeve kundrejt marrësit në një sistem/stacion radiokomunikimi, i cili shoqërohet me përkeqësim të cilësisë, keqinterpretim ose humbje të informacionit, që duhet të përftohej në mungesë të energjisë së padëshiruar.
- 4.10. **“Interferencë e dëmshme”** është ndërhyrja, e cila rrezikon funksionimin e shërbimit të radionavigimit ose shërbimeve të tjera të radiokomunikacioneve, të ofruara për qëllime sigurie, ose ndërhyrja që seriozisht përkeqëson, pengon ose ndërpret, në mënyrë të përsëritur, shërbimet e radiokomunikimeve, që janë duke punuar në përputhje me këtë ligjin 9918 dhe akte të tjera nënligjore.
- 4.11. **“Rregullore Nderkombetare”** janë Rregullore, rregulla, standarte, specifikime, perfundime, rekomandime ose marrveshje që njihen nga AKEP në nivele nderkombetare.
- 4.12. **“ITU”** është Unioni Nderkombetar i Telekomunikacioneve, një Agjensi udhëheqese e Shteteve të anetaresuar në këtë institucion të cila krijon standartet dhe rregullat për informacionin dhe teknologjinë e komunikimit.
- 4.13. **“Plani Kombëtar i Frekuencave”** është plan i hartuar bazuar tek Rregulloret Radio të ITU dhe Publikimet CEPT, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare apo nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizata ndërkombëtare, përcakton brezat e frekuencave për shërbimet e komunikimit radio dhe tregon alokimin e brezave të radio frekuencave duke dhënë një pamje të përgjithshme të përdorimit të spektrit të radio frekuencave në kuadër kombëtar dhe ndërkombëtar.
- 4.14. **“Përdorues”** është cilido që përdor ose kërkon të përdorë shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun.
- 4.15. **“Shërbime Paresore”** janë shërbime Radiokomunikimi të cilat kanë prioritet më të lartë se sa Shërbimet Dytësore, për këto raste merren masa të vecanta mbrojtje nga interferencat e dëmshme kur ato identifikohen në Radiokomunikime. Emertimi i këtyre shërbimeve Radiokomunikimi shfaqet me germa kapitale në Planin Kombëtar të Frekuencave.

- 4.16. **“Sherbime Radiokomunikimi”** jane transmetime ne dhenie ose ne marrje te Frekuencave Radio te cilat mund te perdoren per komunikimet data, mesazhe, ze, pamje, per perdorim ose kontroll te makinerive ose aparaturave.
- 4.17. **“Frekuenca Radio”** eshte rrezatimi elektromagnetik energjia matet ne Hz ose ne cikle/sek.
- 4.18. **“Autorizim Individual per Frekuence”** eshte dhenia e te drejtes se perdorimit te frekuences ne baze te termave dhe kushteve te percaktuara nga AKEP.
- 4.19. **“Rregulloret e Radiove”** eshte nje publikim i ITU, i pervtesuar nga Konferenca Boterore e Radiokomunikimit.
- 4.20. **“Instrumenta Regulluese”** eshte cdo instrument i lejuar nga AKEP me fuqine e tij e cila perfshin rregulloret, direktivat, udhezimet, rekomandimet dhe politikat e AKEP.
- 4.21. **“Sherbime Dytesore”** jane sherbime Radiokomunikimi te cilat nuk duhet t'ju shkaktojne nderhyrje te demshme stacioneve te Sherbimeve Paresore. Keto raste shfaqen ne Planin Kombetar te Frekuencave si raste me me pak peshe.
- 4.22. **“Stacion”** eshte nje instalim i bere nga nje perdorues i Autorizuar, per perdorimin e sherbimeve te Radiokomunikimit.
- 4.23. **“Autorizim i Perkohshem”** eshte dhenia e se drejtes se perdorimit te Brezit te Frekunces nga AKEP e cila lejon perdorimin e frekuences per nje periudhe deri ne 90 dite.
- 4.24. **“Pajisjet Wireless”** jane nje kategori aparatesh te telekomunikacioneve ose pajisje pa tel te cilat perdoren per sherbime Radiokomunikimi.

Neni 5

Administrimi i Interferencave

Administrimi i Interferencave do te kryhet nga Autoriteti i Komunikimeve elektronike dhe Postare per te arritur objektivat qe vijojne:

- 5.1. Parandalimi i interferencave permes administrimit te brezit;
- 5.2. Eleminimi ose minimizimi i Interferencave te demshme te perdoruesve te Autorizuar;
- 5.3. Mbrojtja e frekuencave te perdorura per emergjecat dhe rastet e fatkeqesive;
- 5.4. Kryerja e matjeve te nevojshme te brezit ne rastet e interferencave;
- 5.5. Administrimi i interferencave per Frekuencat e Autorizuara, ne planet e punes.
- 5.6. Percaktimi i vendndodhjes dhe identifikimi i instalimeve dhe perdorimi e pajisjeve wireless te pa autorizuara;
- 5.7. Monitorimi i frekuencave nese kerkohet nga Unioni Nderkombetar i Telekomunikacioneve (ITU) ose ndonje Shtet fqinj per interference te demshme nga stacione brenda territorit te Republikes se Shqiperise;
- 5.8. Lokalizimi i instalimeve te paisjeve zhurmuese te pa autorizuar;
- 5.9. Ne rastet e interferencave eshte e detyrueshme te verifikohen kushtet dhe parametrat teknike te Autorizimit;
- 5.10. Te keshilloje perdoruesit mbi teknikat e uljes se interferencave ne rastet kur stacionet qe interferojne jane te Autorizuar.

Neni 6

Tipet e Interferencave

- 6.1. Interferencat mund te shkaktojne nderpreje te sinjalit, mund te shkaktojne vetem humbje te perkohshme te sinjalit ose mund te shkaktojne humbje te cilesise se sinjalit qe kerkohet nga pajisja. Dy tipet kryesore te interferencave jane zhurmat radio dhe zhurmat elektrike:
 - a) Zhurmat Radio: detajet kryesore jane te vlefshme ne Rekomandimin e ITU-R P-372.

- b) **Zhurmat Elektrike:** Linjat e fuqise ose pajisjet elektrike mund të shkaktojnë interferenca elektrike. AKEP mund të përcaktojë Politikën e Pajtuësive Elektromagnetike me qëllim zvogëlimin e rrezikut nga interferencat elektrike.
- 6.2. Megjithatë, eliminimi i interferencave kërkon ndërmarrjen e hapave direkte dhe indirekte. Hapat indirekte janë parandalues dhe janë të përfshira në Rregulloren për Inspektimin, Monitorimin e Frekuencave dhe Masat Administrative e miratuar për zbatim nga AKEP. Hapat direkte janë fokusi kryesor i kesaj Rregullore dhe sigurojnë mekanizma për të nderhyrë ndaj shërbimeve egzistuese të autorizuara për të eliminuar interferencat e demshme të radiove. Ndërsa AKEP bën caktimin dhe ndarjen e frekuencave kryen planifikimin teknik për të mbrojtur detyrat egzistuese. Parametrat teknike që janë të përshtatshme specifikohen në Autorizimin Individual. Cdo devijim nga këto parametra do të shkaktojë interferencë.
- 6.3. Analiza e interferencave mund të kërkojë që ankuesi të japë të dhëna të hollësishme teknike gjatë aplikimit ndaj AKEP-it. Për këtë qëllim AKEP ka publikuar formularin udhëzues për ankesat ndaj interferencave në mënyrë që përdoruesi i autorizuar të ofrojë informacionin përkatës në adresën në internet: www.aplikimeonline.al. Nëse informacioni i kërkuar nuk është ofruar, AKEP nuk do të jetë në gjendje të vlerësojë interferencën e demshme.

Neni 7

Arsyet që shkaktojnë Interferencat

- 7.1. Arsyet që shkaktojnë interferencat mund të jenë të shumta. Sidoqoftë, disa nga arsyet më të evidentuara janë të shënuara në rregulloren për përdoruesit e autorizuar. Përdoruesit e autorizuar duhet të përpiqen që të shmangin shkaqet e zakonshme të interferencave.
- a) **Nderhyrja Elektrike:** Është një shkak i zakonshëm i interferencave, mbrojtja e duhur tokëzimi mund të mbrojë ndaj interferencave të tilla.
- b) **Rrezatimet jashtë brezit dhe të paligjshme:** Neni 134 i Ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasqyron masat që merren për rrezatimet jashtë brezit dhe

- rrezatimet e paligjshme. Ky nen duhet te respektohet per te shmangur transmetimet jashte brezit dhe transmetimet e paligjshme.
- c) **Toleranca e Transmetuesit:** AKEP ka miratuar rregulla per percaktimin e tolerances se fuqise se lejuar per breza te caktuar te frekuencave. Te gjithë transmetuesit duhet te funksionojne konform ketyre vlerave te percaktuara.
- d) **Fuqia e Rrezatuar e Lejuar:** Eshte e rendesishme per te gjithë perdoruesit te mos tejkalojne fuqine e lejuar te rrezatimit ne menyre qe te mos i shkaktojne interference nje sistemi tjetër.
- 7.2. **Modeli i Antenes dhe Orientimi:** AKEP kryen analizen per caktimin e frekuencave bazuar ne lartesine e antenave dhe modelit te rrezatimit. Cdo ndryshim i parametrave specifike mund te shkaktojë interference ne sisteme te tjera.
- 7.3. **Rritja e Perhapjes per shkak te motit dhe mjedisit:** Ne periudha te caktuara te vitit, ne varesi te kushteve atmosferike, kushtet e perhapjes ndryshojne keshtu stacionet mund te marrin sinjal nga stacione te tjera. Ne hapësirën ajrore, perhapja e vales eshte nje fenomen i vecante i cili lejon perhapjen ne nje distance shume te larte dhe mund te shkaktojë interference te demshme.
- 7.4. **Perdorues i pa Autorizuar:** Per perdorimin e pajisjeve pa tel (wireless) nevojitet autorizimi sipas specifikimeve ne rregulloret dhe politikat e percaktuara nga AKEP. Perdorimi I frekuencave pa Autorizim Individual behet vetem sipas rregullores perkatese dhe supozimi se kjo eshte e lejuar ne ndonje vend tjetër nuk justifikon perdorimin ne Republiken e Shqiperise vetem nese kjo eshte e specifikuar nga AKEP.
- 7.5. **Plani Kombetar i Frekuencave:** PKF ben identifikimin e brezave te frekuencave dhe prioritetet e perdorimit. Percaktimi i pajisjeve ose perdorimi i frekuencave jo ne perputhje me PKF do te shkaktojë nderhyrje te demshme.

Neni 8

Ndjeshmeria e Interferences

- 8.1. Parametrat teknike te autorizuara nga AKEP nuk perlllogarisin ndjeshmerine e nderhyrjes nga pajisjet pa tel (wireless). Megjithate, perzgjedhja e pajisjes eshte e

drejta e Perdoruesit te Autorizuar, per kete qellim Perdoruesi i Autorizuar duhet te vleresoje pajisjen per ndjeshmeri ndaj interferencave.

- 8.2. Niveli i interferences se shkaktuar nga rrezatimi jashte brezit varet nga ndjeshmeria ndaj interferencave te marresit. Marresi duhet te plotesoje nivelin minimal te perforances dhe Perdoruesi i Autorizuar duhet te permbushe standartet e percaktuara per te shmangur rrezatimin jashte brezit dhe rrezatimin e paligjshem.
- 8.3. Per informacion te detajuar mbi zhurmat, ndjeshmerine e marresit dhe selektivitetit te marresit Personat e Autorizuar mund ti referohen rekomandimeve perkatese te ITU. Megjithate, AKEP u rekomandon Personave te Autorizuar qe te marrin ne konsiderate parametrat e meposhtem gjate perzgjedhjes se pajisjes:
 - Ndjeshmeria;
 - Brezi dinamik;
 - Sinjali minimal i dukshem;
 - Raporti sinjal zhurme;
 - Selektimi i kanalit fqinj;
 - Mbrojtjen nga intermodulimi;
 - Mbrojtja nga sinjalet e tjera.

Neni 9

Identifikimi i Burimit te Interferences

- 9.1. Nje Perdorues i Autorizuar duke bere ankesen per interference duhet te jape detaje te nderhyrjes. Percaktimi i vendndodhjes te burimit te nderhyrjes eshte detyre e Sektorit te Monitorimit te Frekuencave dhe Interferencave. AKEP mund te perdore drejtim gjetesit per te gjetur vendndodhjen e burimit te interferences. Megjithate, per lloje te caktuara rrezatimi kur burimi i interferences eshte i levizshem, gjetja e vendodhjes se nderhyrjes mund te kerkoje kohe te gjate monitorimi dhe perfshirje te me shume se nje stacioni monitorimi dhe QKLMF - Qendra Kombetare e Levizshme e Monitorimit te Frekuencave.
- 9.2. Ankesa qe vjen nga perdoruesi do te ndihmoje AKEP per te bere te mundur kryerjen e kesaj detyre. AKEP do te percaktoje shkallen e mbeshtetjes qe kerkohet ne varesi te te dhenave te deruara per interferencen e demshme. Ne

disa raste, per nje mbeshteje e tille mund te kerkohen e kufizime dhe nderhyrje ne sistemet radio te rrjetit te ankuesit.

Neni 10

Shpeshtia dhe Niveli i Interferences

- 10.1. Ankuesit i kerkohet te jape detaje te shpeshtesise dhe nivelit te interferences. Ky informacion kerkohet per caktimin e burimit te interferences dhe kryrejen e procedurave te mitorimit.
- 10.2. Nese shpeshtesia e nderhyrjes se interferuesit eshte shume e rrale, burime te pjesshme mund te caktohen ose udhezohen nga AKEP per te kryer matje.

Neni 11

Interferenca e Lejuar ose e Pranuar

- 11.1. Plani Kombetar i Frekuencave lejon me shume se nje sherbim Radiokomunikimi ne disa breza frekuencash te caktuara si paresore ose dytesore. Per Sherbimet e Radiokomunikimit duhet te kemi disa prioritete ne Planin Kombetar te Frekuencave te cilat percaktohen nga AKEP kur behet caktimi i frekuencave, bazuar ne Planin e Perdorimit te Frekuencave.
- 11.2. Ne Shërbimet e Radiokomunikimit eshte e rendesishme respektimi i parimeve baze te transmetimit dhe rregulloreve per breza te caktuar te frekuencave, ne te kundert mosrespektimi i tyre bën Përdoruesit e Autorizuar pergjegjes për të siguruar që radiot e tyre te mos shkaktojne ndërhyrje për përdoruesit e tjerë të Autorizuar. Keta përdorues nuk mund te kerkojne mbrojtje nga ndërhyrjet.

Neni 12

Interferenca ndaj Perftuesve Publike dhe Aparateve Celulare.

Pajisjet e komunikimit pa tel jane gjithashtu te ndjeshme ndaj formave te ndryshme te interferencave, zhurmave ose nderhyrjeve elektrike. Interferencat ne pajisje te tilla duhet raportuar per trajtim nga ofruesi i sherbimit. AKEP ne kushte normale nuk do te te trajtoje ankesat nese ato nuk vijne tjeter pervec se nga ofruesi i sherbimit.

Neni 13

Interferencat ne Hapesiren Ajrore.

- 13.1. Shërbimet ne hapësirë mund të kategorizohet gjerësisht si stacione hapësinore dhe stacionet tokësore. AKEP është institucioni i ngarkuar për zgjidhjen e të gjitha rasteve të interferencave nese ato shkaktohen nga ndonjë stacion satelitor apo stacion tokësor ne Republikën e Shqiperise.
- 13.2. Në lëshimin e Autorizimit të frekuencave për shërbimin Satelitor AKEP do të përcaktojë në mënyrë të qartë përdoruesit detyrimet për koordinimin dhe kontrollin e interferences se Radios. Me marrjen e nje raporti per interference nga ndonje stacion satelitor apo tokesor ne Republikën e Shqiperise, AKEP duhet te hetoje natyren e interferences dhe te marre masa per zgjidhjen e problemit.
- 13.3. Ankesat për interference të marra nga AKEP nga institucione te tjere në lidhje me shërbimet e hapësirës ne Republikës se Shqiperise do të hetohen dhe të zgjidhen në mënyrë të përshtatshme sipas percaktimeve ne kete rregullore.

Neni 14

Interferenca në Sistemet e Sigurisë Publike

Sistemet e sigurisë publike si siguria ne avionët e fluturimit , frekuencat e sistemit te radio-navigimit , AIS (Sistemi i Identifikimit Automatik, sistem sigurie i perdorur per anijet), EPIRB (Treguesi i Pozicionit te Emergences me Radio Sinjalizim), sistemet sigurisë per raste fatkeqësish, policia, zjarrfikësit, pergjegjesit e mbrojtjes civile, autoritet ndërkombëtare pergjegjese per sistemet e sigurise, autoritet e kërkimit dhe shpëtimit, etj të gjitha kërkojnë disponueshmërinë më të lartë dhe asnjë rast të mos shfaqen interferencave te demshme në brezat e frekuencave te caktuara per pordorim për këto sisteme te cilave do t'ju jepet prioritet i lartë nga AKEP ne zgjidhjen e menjehershme të interferences së dëmshme.

Neni 15

Procedura e Ankeses per Interference

- 15.1. Cdo ankese per interference duhet te depozitohet AKEP duke perdorur formen e “Raportimit te Interferences” (Aneks 1) ne Modulin e Aplikimeve Online te percaktuar i cili eshte ne dispozicion ne faqen Web www.aplikimeonline.al .

- 15.2. Ne rastet kur ka interference te demshme ne frekuencat e sistemeve te sigurise publike dhe sherbimeve ne raste fatkeqesish, ankesa per nderhyrje mund te dergohet ne adresen e meposhteme:

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Godina Torre Drin, Kat IX,

Tiranë, Albania

Tel : + 355 4 2259 571 www.akep.al

Fax : + 355 4 2259 106 info@akep.al

Neni 16

Veprimtaria e AKEP ne zgjidhjen e Interferences

- 16.1. Kur nje ankesë per interference është pranuar, AKEP do të analizojë informacionin e siguruar dhe përshtatshmërinë për të ndermarre veprime. Drejtoria perkatese do të kategorizojë ankesën në vijim dhe veprimet qe do të iniciohen në përputhje me rrethanat:
- a) Interference ne sigurine publike.
 - b) Interference ne Republiken e Shqiperise
 - c) Interference nga jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
 - d) Interference nga Republika e Shqiperise jashte territorit.
 - e) Interference ne hapesiren ajrore.
- 16.2. Per te percaktuar burimin e interferences dhe per te bere eleminimin, AKEP do te marre masat e meposhteme:
- a) Kryerjen e monitorimit e frekuencave radio per te bere identifikimin dhe percaktimin e vendndodhjes se burimit te interferences;
 - b) Kryerjen e një inspektimi me objektet të zbatimit te autorizimit nga ana e shfrytezuesit të autorizuar ne rastet kur ai dyshohet të jetë burimi i interferences për të analiazuar problematikat e ankesës;

- c) Kryerjen e nje inspektimi fizik te vendeve te dyshuara si shkaktare te interferences.
- 16.3. Ankesave per interference ne sistemet e sigurise dhe sistemeve te komunikimit ne raste fatkeqesish do t'ju jepet prioriteti maksimal. AKEP do te inicioje veprime te menjehershme me te dhenat paraprake minimale dhe te marre te gjitha masat e nevojshme per zgjidhjen e interferences.
- 16.4. Ne rastet kur ankesa eshte bere nga Organe Administrative jashte vendit ku sipas shpjegimive dyshohet se burimi i interferences eshte nje Perdorues i Autorizuar kerkohen shpjegime. AKEP mund te kerkoje nderprerjen e transmetimit.
- 16.5. Pergjigjet ndaj ankesave nga jashte Republikes se Shqierise do te zyrtarizohen vetem pas pergjigjes se shfrytezuesit dhe analizes se AKEP. Nese burimi i interferences nuk konfirmohet nga shfrytezuesi dhe behet e ditur frekuenca qe perdor, atehere AKEP do te pregatise detyrat per percaktimin e procedures se monitorimit te stacioneve fikse ne menyre qe te percaktohet vendndodhja e sakte e burimit te interferences.
- 16.6. Kurdohere qe AKEP konstaton interference te demshme per shkak te shkeljes se njerit prej ketyre termave te meposhtme:
- a) Shkelja e termave dhe kushteve të autorizimit të lëshuar nga AKEP për një përdorues të autorizuar,
 - b) Përdorimi i paautorizuar i Brezit te Frekuencave,
 - c) Instalimi i paautorizuar i pajisjeve radio,
 - d) Importi i paautorizuar i pajisjeve transmetuese pa tel (wireless);
 - e) Shkelja e rregullave, rregulloreve ose politikave te AKEP.

procedon ne zbatim te ligjit 9918 dhe akteve rregullatore ne fuqi, ndaj subjektit/sipermarresit (person fizik ose juridik) i cili shkakton interference duke

vendosur komunikim zyrtar ne lidhje me problemin e krijuar, jo me shume se 15 dite nga dita e pranimit te ankeses per interference.

- 16.7. Me vendosjen e komunikimit zyrtar AKEP i ben me dije subjektit qe brenda 5 (pese) diteve kalendarike nga leshimi letres ankuese duhet te marre masa per eliminimin e interferences. Subjektit i jepet mundesia e dhenies se shpjegimeve me shkrim ne lidhje interferencen per te bere te ditur nese nderhyrja eshte e justifikuar. Bazuar ne pergjigjen e perdoruesit nderhyres, AKEP percakton nese shkelja e perdoruesit ishte e qellimshme apo nese kjo ka ndodhur per shkak te arsyeve qe jane jashte kontrollit te perdoruesit.
- 16.8. Në rast të shkeljeve të qëllimshme nga një përdorues ndërhyrës, AKEP do të iniciojë veprime ndaj Përdoruesit ndërhyrës sipas Ligjit 9918 date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar.

Neni 17

Koordinimi per Analizen e Interferences

AKEP ndersa shqyrton zgjidhjen e rasteve te interferences merr ne konsiderate keto mundesi ose opsione te dobishme ne lidhje me natyren e interferences dhe frekuences se sinjalit nderhyres:

- a) Shfrytezimin e koordinuar te mjeteve te monitorimit te institucioneve te tjere brenda Republikes se Shqiperise;
- b) Shfrytezimin e koordinuar te matjeve te monitorimit te sipermarresve te tjere;
- c) Kontakton administraten e cila ka juridiksionin mbi stacionin qe besohet se mund te jete shkak i interferences se demshme sipas dispozitave te ITU-R Radio Rregulloret;
- d) Koordinimin me Autoritetet e vendeve qe kufizojne Republiken e Shqiperise.
- e) Koordinimin me ITU per per detyrat dhe orientimet ne lidhje me analizen dhe zgjidhjen e interferenceses.

Neni 18

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it.



A K E P

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

FORMULAR RAPORTIMI PER INTERFERENCAT RADIO

(ANEKS 1)

Dokument N°: _____

Data: / /

1. TE DHENAT E SIPERMARRESIT/SUBJEKTIT

Emri i subjektit		N° i Autorizimit Individual
Personi i kontaktit per kete ankim (Drejtuesi Teknik)		N° i Autorizimit te Pergjithshem
Adresa		Kodi Postar
Telefon Fiks/Mobile	Fax	E-mail
/		
Kanali (frekuenca) qe interferohet		Menyra e operimit
		Simpleks <input type="checkbox"/> ½ Duplex <input type="checkbox"/> Duplex <input type="checkbox"/>
Tx i kanalit te frekuencave		Vendodhja e Tx dhe koordinatat
Rx i kanalit te frekuencave		Gjeresia e K.Frek. dhe lloji I transmetimit
Fuqia Tx (E.I.R.P)		
W		

2. DETAJE PER INTERFERENCEN RADIO

Pershkrimi i natyres se interferences	
Konstatimi I pare I Interferences	Kanali
/ /	_____
Lloji i interferences	
E vazhdueshme <input type="checkbox"/> Me nderprerje <input type="checkbox"/>	
Ne se eshte me nderprerje:	
Specifikoni kohen kur ajo shfaqet: _____	
Ne cfare intervalesh kohore perseritet: prej _____ deri _____	
Sa eshte koha qe vazhdon te jete prezente ne stacionin radio: _____	

Mbulimi

Qyteti apo rajoni:

Koordinatat:

Intensiteti I sinjalit interferues te marre

I larte I mesem I ulet

Kuptueshmeria e sinjalit interferues te marre

I qarte I kuptueshem I pakuptueshem

Gjuha e perdorur

Shqip Te tjera: _____

Natyra e Interferences

Muzike Biseda Me zhurma Vetem zhurme

Burimi i Interferences

I panjohur I supozuar(jo I sigurt) I njohur *

**jepni informacionet e mundeshme per subjektin qe shkakton kete nderhyrje*

Kanali I Interferencave qe interferon

Gjeresia e kanalit dhe lloji I Transmetimit

Intensiteti i sinjalit RX

Vendodhja e Txt e kanalit Interferues

Perdorni ju Ton Kontrolli ne pajisjet?

Po Jo

Ne se po, cili eshte toni? _____

Jane kontrolluar pajisjet tuaja, pas shfaqjes se interferences, nga fornizuesi i pajisjeve?

Po Jo

Keni Perserites ose Stacion Baze ne perdorim?

Po Jo

Ne se po jepni te dhenat e plota e te sakta per vendndodhjen e secilit prej tyre.

3. Informacion Shtese

Data:	_____ / _____ / _____	Nënshkrimi dhe Vula
Vendi:	_____	_____



A K E P

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

PËRFUNDIMET E KËSHILLIMIT PUBLIK

**MBI “RREGULLOREN PËR
ADMINISTRIMIN E INTERFERENCAVE”**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - AKEP, në zbatim , në zbatim të pikave 9 dhe 10 e nenit 3, gërma a), l) , p), f) n) rr) e nenit 8, neni 110, neni 114, neni 115, neni 134 e në vijim, të Ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, (*ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”*); Vendimi i Keshillit Drejtues të AKEP Nr.2510, datë 30.10.2014 për “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Rregullore mbi administrimin e interferencave” kreu një këshillim publik me palet e interesuara.

Ne përfundim të afatit prej 30 ditësh të përcaktuar në vendimin e mësipërm të KD, rezultoi se pranë AKEP kanë ardhur komente dhe mendime në lidhje me Rregulloren mbi administrimin e interferencave nga palet e interesuara.

Te interesuarit kanë bërë komente e kanë dhënë opinione në lidhje me këtë dokument dhe respektivisht :

- Sipërmarresi **ALBTELECOM Sha**, me shkresën prot AKEP nr.2250/4 datë 10.12.2014, shprehet se vlerëson parashikimet e kësaj rregulloreje në teresinë e tyre dhe nuk ka ndonjë koment apo shtesë për këtë rregullore.
- Sipërmarresi **Vodafone Albania** me shkresën datë 27 .11.2014.

Qëndrimi i Sipërmarrësve mbi Rregulloren për “Administrimin e Interferencave” dhe qëndrimi i AKEP mbi propozimet e paraqitura nga operatorët është si më poshtë vijon:

Vodafone Albania propozon si më poshtë vijon:

Neni 1

Qëllimi – VA kërkon që pjesë e qëllimit të kësaj rregulloreje të jetë dhe përcaktimi i procedurave që do të ndiqen nga AKEP për zgjidhjen e ankesave për interferencë të dëmshme që shkaktohen nga pajisjet fundore të përdorura nga individë të ndryshëm të pa pajisur me **Autorizim Individual**, ndaj subjekteve që zhvillojnë veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike të pajisur me **Autorizim Individual**.

Qëndrimi i AKEP :

*Kapacitetet e AKEP e përfshijnë dhe mundësinë për AKEP për zgjidhjen e ankesave për interferencë të dëmshme që shkaktohen nga pajisjet fundore të përdorura nga individë të ndryshëm të pa pajisur me **Autorizim Individual**.*

Vodafone Albania propozon që të shtohet në objektin e kësaj Rregulloreje edhe pika 2 si vijon:

2. “**Objekti i rregullores** është përcaktimi i procedurave që ndjek AKEP për zgjidhjen e ankesave për interferencat e dëmshme ndaj sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike i pajisur me Autorizim Individual.

Qëndrimi i AKEP :

Mund të kryhet amendim në pikën ekzistuese:

Objekti i rregullores është përcaktimi i procedurave për administrimin e interferencave që kryen AKEP në zbatim të detyrimeve dhe ushtrimit të kompetencave ligjore, gjatë monitorimit të spektrit të frekuencave si dhe zgjidhjen e ankesave për interferencat e dëmshme ndaj sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike (sipërmarrësve), si dhe çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike (subjekti) sipas ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i pajisur me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave, për të mundësuar krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike.

Vodafone Albania sugjeron që në nenin 4, përkufizimi i “**Caktimit**” të amendohet, pasi caktimi është një proces që ndërmerret nga AKEP në zbatim të detyrave dhe funksioneve të tij dhe nuk është një frekuencë:

“**Caktimi**” është dhënia në përdorim nga AKEP, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9918, e frekuencave që përdoren sipas Planit Kombëtar të Frekuencave në Republikën e Shqipërisë nga një ose më shumë përdorues për shërbime tokësore ose radiokomunikime.

Qëndrimi i AKEP :

AKEP duke marrë në konsideratë propozimin e V. A shprehet dakort për sa më sipër.

Vodafone Albania sugjeron që të përcaktohet në tekst kuptimi i akronimit QKLMF – Qendra Kombëtare e Levizshme e Monitorimit të Frekuencave.

VA sugjeron amendimin e nënpikës 1 te nenit 9 si vijon: Nje perdorues i Autorizuar duke bere ankesen per interference duhet te jape detaje te nderhyrjes per aq sa eshte e mundur.

Qëndrimi i AKEP :

*Në lidhje me propozimin e paraqitur nga sipërmarrësi **Vodafone Albania**, AKEP sqaron se përkufizimi neni 9 pika 1 e Rregullores është shprehur qartësisht, duke nënkuptuar që sipërmarrësi duhet të japë detaje të ndërhyrjes për aq sa është e mundur dhe në bazë të informacionit të mbledhur, pra të disponueshëm.*

Vodafone Albania ne lidhje me nenin 10 ngre të njëjtin shqetësim.

Qëndrimi i AKEP :

*Në lidhje me propozimin e paraqitur nga sipërmarrësi **Vodafone Albania**, AKEP sqaron se përkufizimi neni 10 pika 1 e Rregullores është shprehur qartësisht, duke nënkuptuar që sipërmarrësi duhet të japë detaje të shpeshësisë dhe nivelit të interferencës për aq sa është e mundur dhe në bazë të informacionit të mbledhur, pra të disponueshëm.*

Vodafone Albania në lidhje me nenin 11 pika 2 paragrafi i fundit, Interferencë e lejuar ose e pranuar, sugjeron që të qartësohet se për çfarë ndërhyrjesh bëhet fjalë në paragrafin vijues:

Këta përdorues nuk mund të kërkojnë mbrojtje nga ndërhyrjet.

Qëndrimi i AKEP :

Kjo fjali shpreh qartë se behet fjale per nderhyrje qe vijne si rrjedhoje e mosrespektimit te parametrave dhe kushteve teknike te vendosur ne Autorizimin Individual te perdorimit te frekuencave te leshuar nga AKEP.

Vodafone Albania: gjykon se neni 12 i Rregullores nuk jep qartësi se për cilat pajisje behet fjalë dhe kush mund të ankohet ndaj interferencave.

Qëndrimi i AKEP:

Në lidhje me këtë pikë sqarohet se Neni 12 përcakton qartësisht :

Neni 12

Interferenca ndaj Përftuesve Publikë dhe Aparateve Celulare.

1. Pajisjet e komunikimit pa tel janë gjithashtu të ndryshme ndaj formave të ndryshme të interferencave, zhurmave ose ndërhyrjeve elektrike. Interferencat në pajisje të tilla duhen raportuar për trajtim nga ofruesi i shërbimit. AKEP në kushte normale nuk do të trajtojë ankesat nëse ato nuk vijnë tjetër përveç se nga ofruesi i shërbimit.

Vodafone Albania ne nenin 16 Veprimtaria e AKEP ne zgjidhjen e interferences, propozon te te hiqet shprehja pranim i kerkeses per interference pasi le vend per arbitraritet dhe keq interpretim duke i dhene diskrecion ne menyre indirekte AKEP ne mungese te nje procesi transparent dhe pa listuar kushte shteruese dhe afatet perkatese te vendose mbi mospranimin e mundeshem te nje ankese. Ne kete kuptim VA sugjeron qe AKEP duhet te shqyrtoje te gjitha ankesat e pas analizes perkatese te mund te vendose dhe nese ajo eshte pranuar ose jo me arsyetimin perkates. VA gjithashtu propozon qe te percaktohet ne kete nen afati kohor brenda te cilit duhet te trajtohen (kryerja e matjeve, inspektimit , identifikimi i burimit)dhe te zgjidhen nga AKEP ankesat per interference te shkaktuar nga subjekte qe operojne brenda territorit te Shqiperise per secilin prej rasteve te parashikuara ne nenin 16 pikat 2,3,6 dhe 8. Sugjerojme qe afati maksimal brenda te cilit AKEP duhet t'i japi zgjidhje ankesave te siperpermendura te jete sa me i shkurter, por jo me shume se 15 dite nga dita e pranimit te ankeses per interference.

Qëndrimi i AKEP:

Në lidhje me kete pike sqarojme se shprehja e perdorur pranim i kerkeses per interference, nuk perben shkak per arbitraritet apo keqinterpretim.

AKEP shprehet dakort ne lidhje me propozimin per caktimin e nje afati maksimal brenda te cilit AKEP duhet t'i japi zgjidhje ankesave te siperpermendura: te jete sa me i shkurter, por jo me shume se 15 dite nga dita e pranimit te ankeses per interference.

Vodafone Albania në lidhje me *nenin 16 pika 6* propozon që për konsekuencë juridike, pas secilës fjali në pikat b) , c) dhe d) të shtohet në kundërshtim me ligjin 9918 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij” në mënyrë që të mos krijohet konfuzion me përdorimin e frekuencave dhe paisjeve transmetuese të cilat lejohen që të përdoren pa autorizim individual.

Në lidhje me pikën 6 te nenit 16 është shprehur qartesisht:

Kurdoherë që AKEP konstaton interferencë të dëmshme për shkak të shkeljes së njërit prej këtyre termave të mëposhtme:

- a) Shkelja e termave dhe kushteve të autorizimit të lëshuar nga AKEP për një përdorues të autorizuar,
 - b) Përdorimi i paautorizuar i Brezit të Frekuencave,
 - c) Instalimi i paautorizuar i pajisjeve radio,
 - d) Importi i paautorizuar i pajisjeve transmetuese pa tel (wireless);
 - e) Shkelja e rregullave, rregulloreve ose politikave të AKEP.
- procedon në zbatim të ligjit 9918 dhe akteve rregullatore në fuqi, ndaj subjektit/ sipërmarrësit (person fizik ose juridik) i cili shkakton interference duke vendosur komunikim zyrtar në lidhje me problemin e krijuar.

Po në lidhje me nenin 16 përkatësisht në pikat 4 dhe 5 VA kërkon që masat e marra dhe procedurat e ndjekura nga AKEP të jenë në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara dhe standartet nderkombetare të zbatueshme. Në pikën 5 të nenit 16 të rregullores, VA sugjeron të shtohet fjalia si vijon:

Në çdo rast AKEP do të garantojë që masat e ndermarra dhe procedura dhe afatet e zbatuara do të jenë në përputhje me standartet nderkombetare në këto aspekt dhe marrëveshjet e nënshkruara me organet rregullatore kufitare.

Qëndrimi i AKEP:

Në lidhje me këtë pikë sqarojmë se AKEP ka në fokus primar përshtatjen e vazhdueshme në të gjitha aspektet e punës me standartet europiane, duke e cilësuar dhe në pikën 4 të bazës ligjore të kësaj Rregulloreje, për rrjedhojë AKEP merr në konsideratë propozimin Tuaj.

Vodafone Albania propozon në lidhje me nenin 16 pika 7 që afati brenda të cilit subjekti duhet të marrë masa për eliminimin e interferencës me kërkesë të AKEP të jetë në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara mes organeve rregullatore ku operatorët kanë aderuar dhe mbi gjithçka duhet të drejtohen nga parimi i proporcionalitetit dhe kohës së arsyeshme në dispozicion për shqyrtimin e problemit. Në këtë kuptim gjukojmë që nevojiten të pakten 5 ditë pune dhe jo 3 ditë kalendarike me qëllim që subjektit të jepet koha e nevojshme për të dhënë shpjegime për eliminimin e interferencës pavarësisht rrethanave (kushteve atmosferike vendodhjes së pajisjeve, ditëve të pushimit zyrtar) si dhe t'i jepet koha e nevojshme për të dhënë shpjegime pas verifikimeve përkatëse të vetë subjektit në terren.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP merr ne konsiderate propozimin tuaj per zgjatjen e afatit kohor me qellim qe subjektit ti jepet koha e nevojshme per te dhene shpjegime per eliminimin e interferences.

Vodafone Albania propozon qe ne nenin 16 te shtohet pika 9 me permbajtje si me poshte vijon:

“Ne rast te interferencave te demshme te shkaktuara ndaj subjekteve qe ushtrojne veprimtarine ne fushen e komunikimeve elektronike te pajisur me Autorizim Individual, nga paisje radio te paautorizuara te cilat jane ne perdorim privat te te individeve te ndryshim (perdorues nderhyres) , AKEP do te ndermarre veprimet e parashikuara ne pikat 2,6 dhe 7 per percaktimin e burimit te interferences se demshme. AKEP do te bashkepuoje me operatorin I cili ofron sherbimet e komunikimit elektronik per perdoruesin nderhyres ne kete rast, per nderprerjen e sherbimit me qellim eliminimin e interferences se demshme.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP nuk e mer ne konsiderate propozimin e sipercituar pasi vlereson se eshte arritur objektivi mbi Veprimtarine e AKEP ne zgjidhjen e Interferences

Vodafone Albania sugjeron te shtohet ne nenin 17 pika 2 me permbajtje si vijon:

“ Ne rast se ne perfundim te procesit te administrimit te interferences subjektit te autorizuar nuk i garantohet shfrytezimi i spektrit te dhene ne perdorim ne menyre eficente AKEP do te marre ne konsiderate zevendesimin e brezit me interference sipas dispozitave ligjore ne fuqi”.

Qëndrimi i AKEP:

Jashte qellimit dhe objektit te kesaj Rregulloreje.

Konkluzione të Grupit të Punës:

Sipërmarrësit parimisht shprehen dakort me Rregulloren për Administrimin e Interferencave. Grupi i Punës pasi mori në konsideratë komentet e palëve të interesuara, vlerëson se përgjithësisht sipërmarrësit janë dakort me Rregulloren e propozuar nga AKEP për “Administrimin e Interferencave”.

Për sa më sipër grupi i punës i propozon Këshillit Drejtues të AKEP:

1. Miratimin e Rregullores “Për Administrimin e Interferencave”.
2. Publikimin e mendimeve dhe komenteve të palëve të interesuara, sipas dokumentit bashkëlidhur.

Për Grupin e Punës:

Vasil Mitezi Kryetar

Ermir Pina Anëtar

Laert Kokthi Anëtar

Iris Xhanaj Anëtare